

## **AKT THEMELIMI**



**"VISIONFUND ALBANIA"**

World Vision International (WVI), një shoqeri e regjistruar ne Kontene e Los Angeles, Kaliforni, ShBA, ne perputhje me ligjet e Kalifornise, me scili ne 800 West Chestnut Avenue, Monrovia, Kaliforni, 91016, ShBA, perfaqesuar nga Zevendesi-Presidenti i WVI, David A. Robinson.

Ka vendosur te nenshkruaje Aktin e Themelimit si me poshte, per një shoqeri me perjegjesi te kusizuar, te krijuar ne Shqiperi dhe qe i nenshtrohet legjislacionit te Republikes se Shqiperise.

### **Neni 1**

Emri i shoqerise do te jetë "VisionFund Albania" Sh.p.k..

### **Neni 2**

Selia ligjore e shoqerise eshte ne:  
Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", Nr. 26, Tirane, Shqiperi.

### **Neni 3**

Kohezgjatja e shoqerise eshte e perhershme.

### **Neni 4**

Aktiviteti i shoqerise eshte:

1. dhienia hua e parave
2. emetimi, pranimi dhe administrimi i metodave te pageses;
3. ndermjetesimi ne transaksione monetare (perfshi shkembimin e parave);
4. ushtrimi i leasing-ut financiar;
5. ofrimi i sherbimeve ne formen e kasafortave te sigurise;
6. ofrimi i bonove dhe obligacioneve (qe nuk konsiderohen se garanci bankare);
7. sherbimi si agjent apo keshilltar financiar, (nuk perfshihen ketu sherbimet e permendura ne paragrafet 3/a dhe 3/b te Nenit 26, te Ligjit 8365 "Mbi bankat ne Republiken e Shqipërisë");
8. marrja e te drejtave te tjera, perveç te drejtave te pronesise si die tregtimi i ketyre te drejtave;
9. blerja apo marrja ne perdorim apo me qira te tokes bujqesore, ose ne zoterim te perkoqshem apo marrja ne menyra te tjera dhe kontrolli i pasurive te

pajuajtshme apo interesave, pasurive te luajteshme dhe te drejtave dhe privilegjeve te çfaredo lloji, te nevojshme apo te lidhura me punet e shoqerise ne çdo zyre te degeve te shoqerise:

10. hyrja ne marreveshje ekskluzive me shoqeri shqiptare apo shoqeri te huaja.

Shoqeria mund te angazhohej gjithashtu ne veprimtari te ngashme qe jane te ligjshme dhe lidhen me qellimin e veprimtarise se shoqerise.

#### Neni 5

Kapitali themelor i Shoqerise perbehet nga mjete monetare te barabarta me 100 000 (njeqind mijë) leke.

#### Neni 6

Kapitali themelor i Shoqerise eshte i ndare ne 1.000 aksione, te vleresuar secili ne menyre te barabarte. Vlera nominale e çdo aksioni eshte e barabarte me 100 (njeqind) leke dhe i eshte shlyer plotesisht aksionereve te shoqerise. Aksionet e kapitalit zoteroohen nga World Vision International.

#### Neni 7

Pjese te kapitalit jane te transferueshme ndaj paleve te treta ne perputhje me procedurat e parashikuara nga nen 47 i Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi shoqerite tregtare".

#### Neni 8

"VisionFund Albania" Sh.p.k. do te drejtohet nga nje administrator. Kohezgjatja e detyres se administratorit eshte 3 (tre) vjet dhe ai mund te rizgjidhet.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te ushtruar te gjitha formalitetet e parashikuara nga ligji dhe plotesimin e te gjitha detyrimeve per formimin dhe regjistrimin e saj ne perputhje me ligjin.

Ai eshte i autorizuar te veproje ne emer te shoqerise qe nga formimi deri ne regjistrimin e saj ne gjykate. Ai eshte i autorizuar te nenshkruaje te gjitha aktet dhe te ushtroje ne emer te shoqerise te gjitha detyrimet e shoqerise qe nga momenti i regjistrimit dhe ai mund t'ia delegoje disa kompetencia personave te tjere me ane te nje prokure.

#### Neni 9

Kushtet e punes, shperblimet, oraret e punes, pushimet dhe sigurimet shoqerore te personelit do te rregullohen nga kontrata e punes dhe legjislacioni shqiptar.

#### Neni 10

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin nga interpretimi, zbatimi dhe vendimi i ketij Akti Themeli, si dhe mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet aksionereve

te ardhshem ose mosmarreveshje te tjera, do te zgjidhen ne menyre miquesore. Nese nuk arrihet pajtimi, palet mund t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Tirane.

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne kater kopje te gjitha me vlore te rrejtje ligjore.



Lekuar dhe nenskruar nga  
Aksioneri dhe Themeluesi,  
World Vision International  
David A. Robinson  
Zevendes-President Rajonal  
Firma

Me 06 shkurt 2007

Perktheu: Tomi Nakuçi

# WORLD VISION INTERNATIONAL

## AKT THEMELIMI

### AKT THEMELIMI

#### I WORLD VISION INTERNATIONAL

(i amenduar me 17 shtator 1992)

Ne, te nenshkruarit, qytetare te Shtetit te Kalifornise, me ane te kesaj bashkohemi se basbka per qellimin e krijimit te nje shoqerie jo-sitimprurese sipas dispozitiveve te Pjeses I, Divizioni 2 i kreti 1, Seksionet 9900-9802 te Kodit te Shoqerive te Shtetit te Kalifornise, si vijon:

E PARA

Vimi i kesaj shoqerie eshte:



WORLD VISION INTERNATIONAL

E DYTA

Seksioni A:

Shoqeria eshte organizuar ekskluzivisht per qellimet qe jane te dylishta setare dhe bamirese, qe do te thote te deshmoje Jeza Krishtin me jete, vepra, fjale dhe faktie, duke kryer sherbimin e shenjte kristian anembane hotes midis te varferve pa dallim race, ngjyre, besimi apo seksji.

Seksioni B:

Me qellim qe te permbojse qellimet e mesiperme te shoqerise, shoqeria mund te ushtroje kompetencat qe jane te nevojshme per arritjen e tyre, duke perfshire sidomos (po jo e kufizuar ne te) kompetencen per te kerkuar dhe per te marre donacione, trashegimi dhe testamente per qellime te tilla setare dhe gjithashu ne mbeshtetje te qellimeve te tilla siç deklarohet me siper, te kryeje ato te parashikuara ne Seksionin 9501 te Kodit te Shoqerive te Shtetit te Kalifornise, kur ky i referohet kompetencave te shoqerive jo-sitimprurese. Ne mbajtjen e çdo pronë ne besim, shoqeria duhet te beje ç'eshte e nevojshme per mbajtjen, investimin, reinvestimin, manaxhimin dhe shperdarjen e ketij besimi, gjithçka ne perputhje dhe ne mbeshtetje te qellimit paresor te shoqates, ashtu siç eshte shprehur ne Seksionin A te ketij nen te Dite.

### Sekzioni C:

Kjo shoqeri ne vazhdimesi dhe ne menyre te palekundur do te perbrahe deklaraten ne vijim te besimit te shoqerise, qe tregohet me poshtje ne shtate (7) neparagrafe te kufij Sekzioni C, per te deshnuar se:

- (1) Ne besojme se ka nje Zot, qe ekziston perjetesish qe tre persona: Atti, i Biri dhe Shpirti i Shenjte.
- (2) Ne besojme ne hyjnine e Zotit tone Jezu Krishti, ne lindjen e Tij ne menyre te virgjer, ne jeten e Tij te pamekate, ne mrekullite e Tij, ne vdekjen e Tij per te fare gjynahet e te tjereve nepermjet derdhjes se gjakut te Tij, ne ringjalljen e Tij trupore, ne ngritjen e Tij ne doren e djathtte te Attit, dhe ne rikthimin e Tij personal ne pushtet dhe faudi.
- (3) Ne besojme se Bibla eshte Fjala e Zotit e fimezuar, e vetmja e pagabueashme dje autoritare.
- (4) Ne besojme se per shpetimin e njeriut te humbur dhe mekatar, rigjenerimi nga Shpirti i Shenjte eshte absolutisti themelor.
- (5) Ne besojme ne institucionin e tanisheve te Shpirte Shenjte nga qendrimi i te cilla i krishterit behet i afis te jetoje nje jetë hyjnive.
- (6) Ne besojme ne ringjalljen e te dyve, teste shpirte ~~perkastje~~ dje te te humburit; ata qe shpetohen me ringjalljen e jetes dje ata qe humbasia me ringjalljen e mallkimit.
- (7) Ne besojme ne unitetin shpirteror te besintareve ne Zotin tone Jezu Krishti.

Deklarata e besimit sa me siper eshte themeli baze doktrinor per kete shoqeri, dje kjo mak do te ndryshohet, apo fshihet nga ky akt themelimi me perjashtim te rastit kur votojne apo jepin përqimin per nje gje te tille te gjithe anetaret.

### Sekzioni D:

Kjo eshte nje shoqeri jo-sitimprerese qe nuk parashikon te beje fitim per anetaret e saj apo per persona te tjere. Asnje anetar nuk do te kete ndonje perfisim pronesor apo interes te tille ne te. Shoqeria nuk do te nixjerre ndonje kapital. Asnje anetar apo drejtore nuk do t'i neashistrohet perqiegjesise per detyrime apo vleresime te çfaredo luaji.

### Sekzioni E:

Shoqeria nuk do te angazhohet ne asgne perpjekje qe ka si qellim te ndikoje legjislacionin as nuk do te marre pjesa apo nderhyje ne ndonje fushat politike.

### E TRETA

Selia e shoqerise ku do te kryhen transaksionet kryesore te biznesit te saj do te vendoset ne County of Los Angeles, Shteti i Kalifornise.

### E KATERTA

Emrat dhe adresat e personave qe do te veprojne ne cilesine e drejtoreve deri ne zgjedhjen e pasardhesve te tyre jane si vijon:

#### EMRI

#### ADRESA

Dr. W. Stanley Mooneyham

2227 Canyon Drive  
Arcadia, California 91006

Dr. Theodore W. Engstrom

3205 La Encina Way  
Pasadena, California 91107

Dr. Carlton Booth

2472 Frost Mountain  
Pasadena, California 91104

Numri i autorizuar i drejtoreve te kesaj shoqerie mund te ndryshohet nga nje Statut i miratuar rregullisht.

### E PESTA

Nomri i autorizuar, cilesimet dhe çeshtjet e tjera qe lidhen me anetaret e kesaj shoqerie do te rregullohen nga Statuti.

### E GJASHITA

Statuti i kesaj Shoqerie do te miratohet nga drejtoret e emeruar ne Aktin e Themelimit te Shoqerise, dhe me vone mund te ndryshohen apo shfuqizohen me ane te mjeteve te parashikuara nga Statuti.

### E SHTATA

Prona e kesaj shoqerie u dedikohet ne menyre te parevokueshme qellimeve fetare dhe asnjë pjese e te ardhurave apo aseteve te kesaj organizate nuk do te sjelle fitime per ndonje drejtor, nepunes apo anctar te saj apo perfitime per ndonje person privat. Me shperdarjen dhe likudimin e kesaj shoqerie, asetat e saj qe mbeten pas pagesave apo dispozitave per pageset te gjithe borxheve dhe per gjegjesive do te shperndahen ne World Vision Inc; (nje shoqeri e Kalifornise) nese kjo do te ekzistoje dhe do te jetet e lire sipas Seksionit 501 (c); por nese kjo nuk ekziston me ose nuk eshte e lire, ne nje organizate tjeter qe eshte organizuar dhe vepron ekskluzivisht per qellime fetare kristiane qe ka rregulluar statusin e saj per tu perjashtuar nga taksat sipas Seksionit 501 (c) (3) te kodit te Ardhurave te Brendshme. Nese kjo shoqeri mban ndonje aset ne besim ose nese shoqeria eshte krijuar per qellime bamiresie, asete te

tilla do te perdoren ne menyre te tille siç mund te vendoset me vendim te Gjykates se Larte te Kontese ne te cilin shoqeria ka zyren e saj kryesore pas kerkeses se Prokurorit te Pergjithshem apo ndonje personi qe ka te beje me procesin e likuidimit ne te cilin Prokurori i Pergjithshem eshte pale.



Deshmojme me doren tone kete 30 nentor 1977

(firma) W. Stanley Mooneyham

(firma) Theodore W. Engstrom

(firma) F. Carlton Booth

SHTETI KALIFORNISE  
County of Los Angles

Sot me 30 nentor 1977, para meje, te nenshkruarit, Noter Publik ne dhe per Kontene  
dhe Shtetin e mesiperm, personalisht u paraqiten W. Stanley Mooneyham, Theodore  
W. Engstrom, F. Carlton Booth te njojur nga une si personat emrat e te cileve janë  
nenshkruar ne dokumentin e mesiperm dhe njihen si hartuesit e tij.

Deshmoj me doren dhe vulen time

(firma) Florence M. Weingarten  
Noter Publik ne dhe per Kontene  
e Los Angeles, Shteti i Kalifornise

## STATUT

### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR VISIONFUND ALBANIA " sh.p.k.

#### Kapitulli 1 Emertimi – objekti Selia – Kohezgjatja

##### Neni 1

Eshte themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "VisionFund Albania" Sh.p.k..

##### Neni 2

Objekti i shoqerise "VisionFund Albania" Sh.p.k. eshte si me poshte:

1. dhenia hua e parave
2. emetimi, pranimi dhe administrimi i metodave te pageses;
3. ndermjetesimi ne transaksione monetare (perfshi shkembimin e parave);
4. ushtrimi i leasing-ut finanziar;
5. ofrimi i sherbimeve ne formen e kasafortave te sigurise;
6. ofrimi i bonove dhe obligacioneve (qe nuk konsiderohen se garanci bankare);
7. sherbimi si agjent apo keshilltar finanziar, (nuk perfshihen ketu sherbimet e permendura ne paragrafet 3/a dhe 3/b te Nenit 26, te Ligjit 8365 "Mbi bankat ne Republiken e Shqipësie");
8. marrja e te drejtave te tjera, perveç te drejtave te pronesise si dhe tregtimi i ketyre te drejtave;
9. blerja apo marrja ne perdorim apo me qira te tokes bujqesore, ose ne zoterim te perkohshem apo marrja ne menyra te tjera dhe kontrolli i pasurive te paluajtshme apo interesave, pasurive te luajtshme dhe te drejtave dhe privilegjeve te çfaredo lloji, te nevojishme apo te lidhura me punet e shoqerise ne çdo zyre te degeve te shoqerise;
10. hyrja ne marreveshje ekskluzive me shoqeri shqiptare apo shoqeri te huaja.

Shoqeria mund te angazhohet gjithashtu ne veprimtari te ngjashme qe jane te ligjshme dhe fidhen me qellimin e veprimitarise se shoqerise.

##### Neni 3

Selia ligjore e shoqerise eshte ne:

Ruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", Nr. 26, Tirane, Shqiperi.

#### **Neni 4**

Selia ligjore partnere qe mban marredheniet me shoqerine eshte selia kryesore e shoqerise.

#### **Neni 5**

Kohezgjatja e shoqerise eshte e perhershme.

#### **Neni 6**

Shoqeria mund te krijoje dege ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtje territorit te Republikes se Shqiperise.

### **Kapitulli II Kapitali i shoqerise dhe aksionet**

#### **Neni 7**

Kapitali themelor i Shoqerise perbehet nga mjete monetare te barabarta me 100 000 (njeqind mijë) leke.

#### **Neni 8**

Kapitali themelor i Shoqerise eshte i ndare ne 1,000 aksione, te vleresuar secili ne menyre te barabarte. Vlera nominale e çdo aksioni eshte e barabarte me 100 (njeqind) leke dhe i eshte shlyer plotesisht aksionereve te shoqerise. Aksionet e kapitalit zoteroohen vetem nga **World Vision International**.

#### **Neni 9**

Pjese te kapitalit themelor te shoqerise jane te transferueshme ose te transmetueshme ne rruge trashegimie, ndarje te aseteve te bashkeshorit, ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

Pjese te kapitalit themelor te shoqerise mund tu transmetohen paleve te treta eksluzivisht dhe vetem me miratimin me shkrim te aksionereve qe perfaqesojne jo me pak se ¼ % te kapitalit themelor te shoqerise.

### **Kapitulli III Asambleja (mbledhja e per gjithshme e aksionereve)**

#### **Neni 10**

Administratori i shoqerise therret mbledhjet e zakonshme dhe te jashtezakonshme te aksionereve.

Ate mund te mbahen edhe jashtje selise kryesore, me ane te ftesave derguar çdo aksioneri ne rezidencen e tij, te regjistruar ne Librin e shoqerise, se pakt 15 (pesembedhjete) dite para mbledhjes se aksionereve. Ne letren e fteses do te shenohet vendi, dita dhe ora e mbledhjes se aksionereve, si dhe lista e temave qe do te

trajtohen. Çdo aksioner mund te marre pjesë ne mbledhje personalisht ose te perfaqesohet nga dikush tjeter me një akt perfaqesimi.

### **Neni 11**

Mbledhja e per gjithshme e aksionereve drejtohet nga një kryetar. Ne mungese te tij, mbledhja mund te zgjedhe një kryetar te ri.

### **Neni 12**

Mbledhja e per gjithshme e aksionereve ne mbledhjen e saj te pare diskuton dhe merr vendime bazuar ne vota, te cilat perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e kapitalit te shoqerise. Kjo mbledhje vendos per tema te tilla si: amendamente te statutit, zvogelim i kapitalit te shoqerise, zmadhim i kapitalit te shoqerise, shnderrim i shoqerise ne një lloj tjeter shoqerie. Likuidim, caktim dhe shkarkim i eksperteve kontabel te autorizuar, i likuiduesve, miratim i raporteve te admininstrimit dhe kontrollit, miratim i inventarit vjetor dhe ndarje e fitimeve, etc.

### **Neni 13**

Vendimet e mbledhjes se per gjithshme te aksionereve merrin ne menyren qe i duket e pershtatshme personit qe kryeson mbledhjen.

### **Neni 14**

Vendimet e mbledhjes se per gjithshme te aksionereve te marra ne perputhje me ligjin dhe me kete Statut jane detyruese per te gjithe aksioneret ekzistues dhe te ardhshem.

## **Kapitulli IV Drejtimi**

### **Neni 15**

"VisionFund Albania" Sh.p.k. do te drejtohet nga një administrator. Kohenzgjata e detyres se administratorit eshte 3 (tre) vjet dhe ai mund te rizgjidhet.

### **Neni 16**

Administratori e shoqerise kane te drejte te ushtrojne te gjitha veprimet qe kane te bejne me drejtimin normal te shoqerise, perveç kompetencave ose te drejtave qe takojne mbledhjes se per gjithshme te aksionereve.

Administratori e shoqerise kane te drejte te nenshkruajne ne emer te shoqerise si dhe te perfaqesojne shoqerine ne marredheniet me te tretet, si dhe te parfaqesojne shoqerine ne gjykata, institucionale shteterore, institucionale vendore, njesi ligjore, etj.

Administratori e shoqerise jane per gjegjes per kompanine para paleve te treta per shkelje te ligji ose demtime shkaktuar gjate drejtimit te shoqerise.

Administrator i shoqerise eshte Kastriot Laloshi.

### **Neni 17**

Administratoret e shoqerise kane te drejte te emerojne drejtorin teknik te ndermarrjes ose dhe njc teknik administrativ;

### **Neni 18**

Mbledhja e aksionereve do te percaktoje shperblimin e administratorit te vetem, pertej shpenzimeve te kryera gjate detyes per drejtimin e shoqerise.

## **Kapitulli V**

### **Kontrolli i aksionereve**

### **Neni 19**

Cdo aksioner ka te drejte te marre njoftime nga administratori ne lidhje me punet e shoqerise si dhe te konsultoje librat e shoqerise.

## **Kapitulli VI**

### **Bilanci dhe mjetet**

### **Neni 21**

Cdo vit finansiar fillon ne Janar dhe mbylltet ne 31 Dhjetor te cdo viti (viti i pare perjashtohet).

Ulogarite vjetore, inventaret, raportet e operacioneve gjate vitit finansiar, raportet speciale te hartuara nga manaxheri dhe eventualisht hartues te autorizuar, do te miratohen nga mbledhja e aksionereve me shumice (kjo shumice perfaqson jo me pak se 2/3 e kapitalit te Shoqerise).

Miratimi i akteve qe kane te bejne me veprimtarine vjetore te shoqerise duhet te kryhet ne afatin e tre muajve nga dita e mbylljes se vitit finansiar.

### **Dividendet**

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe vertetimit te ekzistences se fitimeve, dhe pas mbajtjes nga keto fitime te shpenzimeve te kryera gjate administrimit te kompanise si dhe nga manaxheri, shperblimit te drejtorit teknik dhe mbajtjes nga ky fitim te fondit te rezerves (5% e fitimit te cdo viti, sa te arrije 1/10 e kapitalit themeltar), cka mbetet do te ndahet ndermjet aksionereve me vendim njezeri. Nese per ndonje arsyte unanimiteti ne menyren e ndarjes se fitimeve deshton, atehere fitimet automatikisht do te ndahen sipas perqindjeve qe zotrojne aksioneret ne kapitalin e kompanise.

## **Titulli VII**

### **Shperdarja dhe likujdimi**

### **Neni 23**

Kompania shperndahet ne te gjitha rastet e parashikuara nga Ligji.

### **Neni 24**

Kompania hyn ne proces likuidimi ne momentin e shperdarjes. Asambleja e aksionereve do te percaktoje modalitetet e likuidimit si dhe do te caktoje nje ose me shume likujdues.

### **Titulli VIII Maredheniet e punes**

### **Neni 25**

Marredheniet e punes ndermjet Shoqerise dhe punonjesve te saj do te disiplinohen nga kontratat kolektive dhe individuale. Ne lidhje me dispozitat qe nuk jepen ne kete marreveshje do te zbatohen ligjet Shqiptare ne force.

### **Titulli IX Juridiksoni i gjykatave**

### **Neni 26**

Cdo mosmarreveshje ne lidhje me interpretimin e ketij statuti apo akteve te tjera te shoqerise ose gjate veprimarise se shoqerise do te zgjidhet me bisedime. Nese per ndonje arsye bisedimet deshtojne atchere autoriteti kompetent qe do te zgjidhe mosmarreveshjet eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

### **Titulli X Te pergjithshme**

### **Neni 27**

Ajo qe nuk parashikohet shprehimisht ne kete Statut do t'i referohet Ligjet Nr. 7638 te dates 19 nentor 1992 "Per Shoqerite Tregetare", Kodit Civil Shqiptar si dhe ligjeve te tjere shqiptare ne fuqi.

Ky statut eshte shkruar ne kater kopje e vlore te barabarte.

**AKSIONERE**

Miratuar nga Aksioneri dhe Themeluesi, World Vision International

Firma

-----  
David A; Robinson  
Zv-Presidenti Rajonal